



**VENDIM**

**Nr. 78 , Datë 07.06.2016**

**MBI  
MIRATIMIN E KONTRATËS “PËR SHIT-BLERJEN E ENERGJISË  
ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE TEKNIKE NË  
SISTEMIN E TRANSMETIMIT NDËRMJET OST SH.A DHE KESH  
SH.A”**

Në mbështetje të neneve 16; 20 gërma “h” dhe 110, të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; Kapitullit V, të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 68, datë 23.06.2008, të ndryshuar dhe VKM-së nr. 244, datë 30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në mbledhjen e tij të datës 07.06.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtoritë Teknike në lidhje me kontratën “Për shit-blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit,

**Konstatoi se :**

- Palët e kësaj kontrate janë subjekte juridike të legjitimuara për nënshkrimin e kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit” duke patur parasysh që licenca e shoqërisë OST sh.a., në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike është rinovuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 24, datë 26.03.2009 dhe licenca e shoqërisë KESH sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike është rinovuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 23, datë 25.03.2009.
- Sipas parashikimeve të Kapitullit “V”, të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 68, datë 23.06.2008, të ndryshuar, marrëdhënia midis KESH sh.a. dhe OST sh.a. rezulton të jetë marrëdhënie e rregulluar.
- Duke qënë se “Kontrata për shit-blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit” rregullon periudhën 01.01.2016 - 30.06.2016, vlen të sqarohet se baza ligjore në të cilën ajo gjen mbështetje për periudhën 01.01.2016 – 30.03.2016, janë nenet 51, gërmat “b” dhe “d”; 56 gërma “f”, të Ligjit Nr 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike"; parashikimet e

*Modelit të Tregut të Energjisë* miratuar me VKM nr. 338 datë 19.03.2008, i ndryshuar dhe *Rregullat e Tregut* të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.06.2008, të ndryshuar.

Që nga momenti i hyrjes në fuqi të VKM nr. 244, datë 30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, përcaktimet e Modelit të Tregut të Energjisë të miratuar me VKM nr. 338 datë 19.03.2008, i ndryshuar, nuk zbatohen më, duke vendosur kështu detyrimin për të miratuar këtë kontratë sipas VKM nr. 244, datë 30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.

Sqarojmë se VKM nr. 244, datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, nuk ka fuqi prapavepruese dhe si e tillë nuk mund të rregullojë të gjithë periudhën e shkuar në të cilën ka shtrirë efektet kontrata për shit-blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit. Efektet fillojnë nga data e hyrjes në fuqi të kësaj VKM-je.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

#### **Vendosi:**

1. Të miratojë kontratën “Për shit-blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit ndërmjet OST sh.a dhe KESH sh.a”, për periudhën kohore 01.01.2016 - 30.06.2016.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë KESH sh.a dhe OST sh.a për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**